



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10.2.2023

Nr: 51

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE TË BASHKISË BERAT, PËR  
PERIUDHËN 24 JANAR – 2 SHKURT 2023**

Sot, më datë 10.2.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

**SUBJEKT:** Bashkia Berat

**OBJEKTI** Shqyrtim administrativ i raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Berat për periudhën 24 janar deri më 2 shkurt 2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, neni 21, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Gjatë periudhës së monitorimit 24 janar deri më 2 shkurt 2023, Bashkia Berat ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së, 5 (pesë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 25.1.2023,

Data: 10.2.2023 Nr: 51  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Berat, për periudhën 24 janar – 2 shkurt 2023”

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.1.2023,
- Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
- Aktivitet “Këshillim”, raportuar në datë 1.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 5.2.2023.

Në datë 4.2.2023 administrata e KQZ i ka kërkuar Bashkisë Berat nëpërmjet e-mail-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 8.2.2023, ora 11:00.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e saj, Bashkia Berat nuk ka depozituar pretendime pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, krijoi bindjen se aktivitetet janë raportuar jashtë afatit ligjor pa asnjë shkak të justifikuar. Nisur nga tematika e veprimtarive të raportuara, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se këto veprimtari përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Berat ka shkelur detyrimin ligjor duke mosraportuar brenda afatit të përcaktuar.

Nga vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve rezulton se, Bashkia Berat është përsëritëse në shkeljen e detyrimit ligjor të raportimit brenda afatit të përcaktuar të veprimtarive publike.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 21, pika 1 shkronja “dh”, dhe nenin 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2012, “Për kundërvajtjet administrative”, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

## VENDOS:

1. T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për zj. Arisa Toska, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Berat, me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**